

Vendim nr. 37 datë 07.05.2024

(V-37/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga : Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 07.05.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (B) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **BARDHOKE PICAËU**, përfaqësuar nga avokat Marash Logu, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR, KMCAP EPROR PARAPLEGJI, TETRAPLEGJI DHE NEUROLOGJI përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Reme Xholi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2304, datë 06.06.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes administrative nr. 31155-00075-86-2022, me datë regjistrimi 19.01.2022 në Gjykatën Administrative të Apelit.
Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen brenda një afati kohor të caktuar, sa më të afërt.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin

dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Bardhoke Picaku, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Shërbimit Social Shtetëror, KMCAP Epror Paraplegji, Tetraplegji dhe Neurologji, (KMCAP Epror) që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja rezulton se është nëna e shtetases B.P., e cila që nga moshja trevjeçare është diagnostikuar me diagnozën “paraplegji”. Gjithashtu, rezulton se me vendimin nr. 173, datë 27.04.2010 të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) Mirditë, vajza e kërkueses është trajtuar me statusin e paraplegjikut, duke përfituar edhe paketën e veçantë higjienosanitare.

2. Në rikomisionimin e radhës të kryer nga KMCAP-ja Niveli i Parë për Paraplegji Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë vajza e kërkueses është kontrolluar për diagnozën “paraplegji inferiore”, në vijim të epikrizës së lëshuar nga mjeku specialist neuropsikiatër i Poliklinikës së Specialiteteve Mirditë. Me vendimin nr. 877, datë 27.10.2020, KMCAP-ja Niveli i Parë për Paraplegji Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë, ka vendosur dhënien e së drejtës së përfitimit të statusit të paraplegjikut nga data 01.06.2021 deri në datën 01.06.2023, më të drejtë rikomisionimi. Duke qenë se ky vendim është marrë me shumicë votash, pasi kryetari i komisionit nuk ka qenë dakord, vajza e kërkueses ka kaluar për shqyrtim pranë KMCAP-së Epror, me argumentin se është vlerësuar me statusin e paraplegjikut në moshën trevjeçare. Më pas nuk ka pasur asnjë ekzaminim të kryer ose kontroll në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë për statusin e paraplegjikut.

3. KMCAP-ja Epror, me vendimin nr. 414, datë 24.06.2021, ka vendosur që diagnoza e konstatuar është “*Paraparezë inferiore spastike sinistër më shumë se dexter probabilisht në terren PCSI, epilepsia e gjeneralizuar*”. Pas kryerjes së vizitës dhe vlerësimit të dokumentacionit

mjekësor dhe ekzaminimeve përkatëse, KMCAP-ja Epror ka arritur në përfundimin se vajza e kërkueses nuk përfiton statusin e paraplegjikut, por kalon si përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar, grupi i parë me kujdestar. Në këto kushte, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 414, datë 24.06.2021 të KMCAP-së Epror.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3194, datë 16.11.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesja, i cili është regjistruar në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit në datën 19.01.2022. Në datën 15.02.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e çështjes.

5. Sipas informacionit të datës 26.04.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, çështja i ka kaluar me short fillimisht gjyqtarës B.H., më pas gjyqtarës A.N. në datën 15.03.2023 dhe gjyqtarës E.V. në datën 19.09.2023 dhe aktualisht është për shqyrtim nga gjyqtari relator S.I., të cilit i ka kaluar në datën 11.01.2024. Gjykata Administrative e Apelit ka 11 gjyqtarë dhe gjyqtari relator ka 2293 çështje në shqyrtim. Aktualisht, kjo gjykatë po shqyrton çështjet e regjistruara në vitin 2017, si dhe çështjet me përshpejtim me kërkesë të palëve, sipas vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.

6. Në kushtet kur çështja nuk është marrë në shqyrtim, në datën 24.04.2023 kërkuesja ka depozituar në Gjykatën e Lartë kërkesën me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së saj në Gjykatën Administrative të Apelit dhe marrjen e masave për gjykimin sa më të shpejtë të saj.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2304, datë 06.06.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në datën 27.10.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e këtij vendimi dhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky ankim kushtetues individual është dorëzuar në Gjykatë në datën 27.10.2023 dhe pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 03.11.2023. Kolegji i Gjykatës në datën 28.12.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, për sa vijon:

- 8.1. Ankimi është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 19.01.2022, por ende nuk ka një vendim për çështjen. Nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit nuk janë respektuar afatet ligjore, duke i zvarritur ato në mënyrë të paarsyeshme. Gjithashtu, vlerësimi i bërë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, për rrjedhojë vendimi i tij duhet të shfuqizohet dhe ankimi i kërkueses i bërë në Gjykatën Administrative të Apelit duhet të përshpejtohet.
- 8.2. *Sjellja e kërkueses*. Kërkuësja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim, përkundrazi, nuk e ka humbur interesin, madje e ka shfaqur atë në mënyrë të pandërprerë, duke kërkuar përshpejtimin e çështjes.
- 8.3. *Kompleksiteti i çështjes*. Çështja konkrete nuk është komplekse, pasi përpara gjykatës është paraqitur vetëm një pretendim dhe gjykatës së shkallës së parë iu deshën vetëm dy muaj për gjykimin e saj. Kjo është pranuar edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.
- 8.4. *Sjellja e autoriteteve*. Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin material dhe me praktikën që vetë ai kolegji ka vendosur për raste të ngjashme, kur objekt padie është vendimi i KMCAP-së Epror. Çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës ose që kanë ndikim te një fëmijë i mitur u jepet përparësi dhe duhen përshpejtuar nga gjykatat. Fakti që gjykatat në Shqipëri janë duke përballuar një volum të madh çështjes, si pasojë e pakësimit të gjyqtarëve nëpër gjykata për shkak të vetingut nuk e justifikon vonesën në shqyrtimin e çështjes.
- 8.5. *Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuësja*. Interesi i kërkueses rrezikohet nga tejzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore, për sa kohë që e drejta e kërkuar ka të bëjë me të drejta vetjake, siç është përfitimi i pensionit, sidomos kur bëhet fjalë për të drejta të cilat ndikojnë te një person i mitur me aftësi të kufizuara.

9. *Subjekti i interesuar, KMCAE Epror*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

- 9.1. Aktualisht kërkuesja trajtohet me pagesë të aftësisë së kufizuar, grupi i parë, në të cilin vlerësohen personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për përkujdesje, pra nuk i janë cenuar mjetet e domosdoshme të jetesës, përkatësisht e drejta e pensionit, siç është pretenduar nga kërkuesja. Masa e pensionit për personat me aftësi të kufizuara aktualisht është 12.415 lekë në muaj dhe të njëjtën shumë e përfiton edhe ndihmësi personal, pagesa të cilat indeksohen çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror. Subjekti i interesuar ka vepruar në përputhje me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë pengesë për vonesa në gjykimin e çështjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në këtë këndvështrim, kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një

çështje konkrete. Gjykata pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të investohej drejtpërdrejt për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së saj të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e saj. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuëses për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

14. Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave mban datën 06.06.2023, me të cilin kërkuësja është njohur përmes shërbimit postar në datën 26.09.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.10.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuëses të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën ende nuk ka një vendimmarrje dhe as një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuëses do të vlerësohen në këndvështrim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, e cila, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

16. Sipas kërkukses, ankimi i saj është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 19.01.2022 dhe ende nuk ka një vendim për çështjen. Nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit nuk janë respektuar afatet ligjore, duke i zvarritur ato në mënyrë të paarsyeshme.

17. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e vendimit të subjektit të interesuar, KMCAP-së Epror, i cili ka përcaktuar diagnozën e vajzës së saj të mitur, duke e kategorizuar si përfutuese të pagesës së aftësisë së kufizuar, grupi i parë me kujdestar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ankimuar nga kërkuësja. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 19.01.2022, pra aktualisht kanë kaluar 2 vjet e 3 muaj dhe ende nuk ka një vendimmarrje për të.

19. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

20. Në këtë drejtim, paraprakisht, Gjykata vlerëson të theksojë se, sikurse tashmë ka konstatuar gjatë gjykimit të çështjeve që lidhen me kohëzgjatjen e paarsyeshme të afatit në parim, vonesa në gjykimin e çështjeve të individëve është pasojë e ngarkesës së lartë në gjykatat

e juridiksionit të zakonshëm shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgatur prej disa vitesh prandaj edhe metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja, në cilësinë e organit kushtetues, që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 61 datë 20.11.2023; nr. 68 datë 07.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në këto kushte, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjajtje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me *sjelljen e kërkueses*, Gjykata vëren se ajo, pas regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit në datën 19.01.2022, i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes në datën 15.02.2023. Në vijim, në datën 24.04.2023, pra pas rreth 1 viti e 3 muaj nga momenti i regjistrimit të çështjes, i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshem të gjykimit të çështjes dhe marrjen e masave për gjykimin sa më të shpejtë, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sikurse pranohet edhe nga Gjykata e Lartë, nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, të jetë shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në momentin e marrjes së vendimit nga ajo gjykatë për çështjen e kërkueses nuk është kryer asnjë veprim procedural. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se sjellja e kërkueses nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së saj.

23. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes*, Gjykata vëren se çështja ka natyrë administrative, të paditur KMCAP-në Epror dhe një kërkim në objektin e padisë, i cili në thelb lidhet me kundërshtimin e vendimit të këtij organi dhe lënien në fuqi të vendimit të KMCAP-së Niveli i parë për Paraplegji Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje për ankimin e kërkueses. Sikurse thekson edhe Gjykata e Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit të çështjes dhe përsheptimit, çështja nuk paraqitet komplekse, pasi ka të bëjë me shpërblimin e dëmit pasuror dhe moral (jopasuror), si dhe shpenzimet e nevojshme në favor të kërkueses si pasojë e dëmit të shkaktuar nga mjekimi i pakujdesshëm.

24. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë sa është theksuar më sipër për situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor (*shih paragrafin 20 të vendimit*), Gjykata vëren se çështja e kërkueses është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit tashmë prej 2 vjetësh e 3 muajsh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është 2 vjet e 7 muaj. Nga të dhënat e marra nga Gjykata Administrative e Apelit (*shih paragrafin 5 të vendimit*), si dhe sikurse arsyeton Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës së saj për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit dhe përsheptimin e procedurave, gjykata e apelit është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen e kërkueses brenda afatit të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe dhe jo për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Prandaj, në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkueses lidhet me ngarkesën e lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe të gjyqtarit relator, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

25. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*, Gjykata konstaton se pas kryerjes së vizitës dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor, si dhe ekzaminimeve përkatëse, KMCAP-ja Epror ka vendosur që vajza e kërkueses nuk përfiton statusin e paraplegjikut, por kalon si përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar, grupi i parë me kujdestar. Ky vlerësim i KMCAP-së Epror është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendimi i së cilës është ankimuar nga kërkuësja, por nuk është gjykuar ende nga Gjykata Administrative e Apelit.

26. Për të analizuar këtë kriter, Gjykata i është drejtuar kërkueses për paraqitjen e arsyeve dhe shkaqeve se përse gjykimi i çështjes së saj duhej të kryhej me prioritet në Gjykatën Administrative të Apelit. Me shkresën e datës 29.04.2024 kërkuesja ka parashtruar se tejzgjatja e procedurave rrezikon në mënyrë të konsiderueshme interesin e vajzës së saj të mitur, e cila ka humbur të drejtën për t'u trajtuar me përfitimet që i takojnë prej muajit qershor 2021, duke përkeqësuar edhe më tej gjendjen e saj shëndetësore dhe sociale. Gjithashtu, sipas kërkueses, ajo dhe vajza e saj e mitur ndodhen në kushte të vështira socioekonomike.

27. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka parashikuar listën e çështjeve të cilat kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, të tilla, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin (veçanërisht pensionin e invaliditetit) etj. Në një çështje, në të cilën kërkuesit pretenduan se autoritetet nuk kishin përllogaritur në mënyrën e duhur pensionin e invaliditetit, *GJEDNJ*-ja ka vlerësuar se shumica përbënte një pjesë të rëndësishme të pensionit dhe se ai ishte burimi kryesor i të ardhurave, rrjedhimisht autoritetet duhej ta kishin trajtuar çështjen me kujdes të veçantë (*shih Gorokhov dhe Rusyayev kundër Ruisë, datë 17.03.2005, § 34*). Gjithashtu, *GJEDNJ*-ja ka konstatuar cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm edhe në një rast tjetër, pasi ka vlerësuar se procesi gjyqësor i vënë në lëvizje nga kërkuesi lidhej me mjetet e jetesës, ndonëse ai përfitonte një shumë të zvogëluar të pensionit të invaliditetit (*shih Bieliński kundër Polonisë, datë 21.07.2022, § 48*). Të njëjtin qëndrim *GJEDNJ*-ja ka mbajtur edhe kur qëllimi i procesit gjyqësor ka qenë në thelb përmirësimi i situatës së kërkuesit, në kushtet kur pensioni i invaliditetit përbënte të ardhurën kryesore të tij (*shih Mocie kundër Francës, datë 08.04.2003, § 22*).

28. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se çështja e kërkueses, për shkak të natyrës së saj, e cila lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë”, ku përfshihen edhe interesat e fëmijës së saj të mitur, e cila është me aftësi ndryshe, kërkon nga gjykatat shqyrtimin me përparësi të çështjes, veçanërisht kur objekti i mosmarrëveshjes ka të bëjë me pretendime financiare. Në këtë rast, Gjykata mban parasysh dhe vë në dukje se kërkuesja ka pretenduar se ndodhet në kushte të vështira ekonomike, si dhe faktin se interesi i fëmijës së mitur për të gëzuar jetë cilësore të shëndetshme përbën prioritet parësor për çdo institucion, veçanërisht për autoritetet vendimmarrëse me ndikim të drejtpërdrejtë në përkujdesen dhe mirëqenien e tyre. Duke mbajtur në konsideratë faktin se nga momenti i regjistrimit të kërkesëpadisë kanë kaluar pothuajse tre

vjet, ngarkesa me të cilën përballet sistemi i drejtësisë nuk mund të konsiderohet një argument thelbësor për vonesën në gjykimin e saj, për më tepër, kur objekt i gjykimit janë detyrimet ndaj fëmijës së mitur. Gjykata çmon se Gjykata e Lartë e ka analizuar çështjen vetëm në drejtim të kompleksitetit të saj dhe jo të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja, si një aspekt i rëndësishëm i vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Në këtë drejtim, ajo duhet të mbante në konsideratë faktin se pretendimet me natyrë financiare të kërkueses kanë për qëllim mbulimin e shpenzimeve për sëmundjen dhe trajtimin e vajzës së saj të mitur.

29. Nisur nga sa më lart, në vlerësim të analizës së standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se në rrethanat e rastit konkret kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkueses në Gjykatën Administrative të Apelit në raport me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja ka tejkaluar një kufi kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se vlerësimi i kryer nga Gjykata e Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, për rrjedhojë vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave duhet të shfuqizohet dhe gjykimi i ankimit të kërkueses nga Gjykata Administrative e Apelit duhet të përshpejtohet. Për këtë qëllim, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon të caktojë afatin 6-mujor, brenda të cilit duhet të veprojë Gjykata Administrative e Apelit, duke e konsideruar këtë afat të arsyeshëm në raport me të drejtën kushtetuese të kërkueses. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-2304, datë 06.06.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes administrative nr. 31155-00075-86-2022, me datë regjistrimi 19.01.2022.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen brenda një afati 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 07.05.2024

Shpallur më 04.06.2024